



FORUMI
për
SIGURI

**RAPORTIMI I MEDIAVE PËR PAQEN,
KONFLIKTIN DHE ÇËSHTJET E
SIGURISË – SA OBJEKTIV
DHE I NDJESHËM NDAJ KONFLIKTIT
ËSHTË RAPORTIMI PËR KËTO ÇËSHTJE?**

Mars 2014



Projekt i financuar nga BE-ja dhe i menaxhuar
nga Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë

FORUMI
për
SIGURI

**RAPORTIMI I MEDIAVE PËR PAQEN,
KONFLIKTIN DHE ÇËSHTJET E
SIGURISË – SA OBJEKTIV
DHE I NDJESHËM NDAJ KONFLIKTIT
ËSHTË RAPORTIMI PËR
KËTO ÇËSHTJE?**

Mars 2014



Projekt i financuar nga BE-ja dhe i menaxhuar nga Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë

Forumi për Siguri synon që të përmirësojë ambientin e e sigurisë duke promovuar institucionie dhe politika efektive. Forumi shërben si një platformë diskutimi në mes të organizatave të shoqërisë civile dhe autoriteteve në Kosovë, dhe mundëson shkëmbimin e experiencave dhe mësimëve për sigurinë në rajon dhe ndërkombëtarisht. Forumi për Siguri përbëhet nga këto organizata: Forumi për Iniciativa Qytetare (FIQ), Instituti për Politika Zhvillimore (INDEP) dhe Instituti i Kosovës për Drejtësi (KLI)

Ekipi i Institutit për Politika Zhvillimore (INDEP) ka përpiluar këtë raport me kontribute nga Forumi për Iniciativa Qytetare, AKTIV dhe anëtarë të Forumit për Parandalim të Konfliktit (CPF) në veri, duke përfshirë Qendrën për Avokim për Kulturë Demokratike, Qendrën e Shoqërisë për Zhvillim, Zdravlje, dhe OSHC-të: Change (Gjilan) Me Dorë në Zemër (Mitrovicë), Qendra Rinore e Prishtinës, Qendra e Shoqërisë për Zhvillim (Leposaviq dhe Zubin Potok) , Qendra e Shoqërisë Civile (Gjakovë) dhe Etnika (Prizren).

Ne duam të falenderojmë Bashkimin Europian, të përfaqësuar nga Zyra e Bashkimit Europian në Kosovë nën Programin për Shoqërinë Civile për Kosovën, për financimin e këtij hulumtimi ndërmjet mbështetjes së tyre për projektin “Fuqizimi i organizatave të shoqërisë civile në Kosovë për t’u bërë kontribuues efektiv të politikave të sigurisë dhe proceseve vendimmarrëse”, që po implementohet nga Saferworld, FIQ dhe AKTIV.

© Copyright

Asnjë pjesë e këtij publikimi nuk mund të riprodhohet, ose amandamentohet pa pëlqimin e publikuesit. Ky publikim është prodhuar me ndihmën e Bashkimit Europian. Përmbajtjet e këtij publikimi janë përgjegjësia e Forumit për Siguri dhe nuk reflektojnë pikëpamjet e Bashkimit Europian.



Përmbajtja

| | |
|---------------------------------------------------------------|----|
| I. Hyrje | 5 |
| II. Metodologjia | 6 |
| III. Korniza Ligjore | 7 |
| IV. Perceptimet – të gjeturat e përgjithshme | 9 |
| V. Mediat, etnitë dhe mbulueshmëria – perceptimi publik | 10 |
| VI. Etnia kryesore – konflikte të injoruara..... | 13 |
| VII. Përfundimet..... | 15 |



I. HYRJE

Sot, Kosova banohet nga tetë grupe të njohura etnike.¹ Dy grupet kryesore etnike, shqiptarët dhe serbët, kanë qenë pjesëmarrësit e një konflikti të armatosur që ka përfunduar në 1999. Ky konflikt ka lënë 13,526 persona që dihen deri tani të vdekur apo të zhdukur². Konflikti gjithashtu ka lënë tensione midis dy grupeve kryesore etnike në vend. Veriu i Kosovës mbetet kryesisht i pa integruar qoftë në sistemin e Kosovës apo Serbisë, ndërkohë që mungesa e stabilitetit socio-politik përbën brengë për tension dhe konflikt në të ardhmen. Vendndodhja dhe fati i shumë personave zhdukur akoma nuk dihet ndërkohë që as krimet e as vrasjet e 1999 nuk janë adresuar nga të dyja palët. Pa marrë parasysh faktin që Kosova nuk konsiderohet më një zonë konflikti, duhet treguar kujdes kur i qasemi çështjeve të cilat potencialisht mund të nderzin konflikt.

Këto çështje të ndjeshme gjithashtu prekin marrëdhëniet brenda një etnie. Ndërkohë që Kosova ecën përpara me shtet ndërtim, problemet ndëretnike fillojnë të marrin një vend në prapavijë për shkak të tensioneve brenda etnive. Shkalla e lartë e larmisë brenda secilit grup etnik në Kosovë, qoftë fetare, arsimore apo regjionale, lë hapësirë të mjaftueshme për acarim. Një gjë e tillë është akoma më problematike kur merret parasysh që ekonomia e vendit vazhdon të mbetet në një pozitë të pafavorshme. Sipas Bankës Botërore, në 2013, bruto prodhimi vendor për kokë banori në Kosovë ka qenë \$3,640 ndërkohë që një e treta e popullatës jeton nën vijën e varfërisë ndërsa një e teta e popullatës jeton në varfëri ekstreme.³ Shkalla e lartë e papunësisë, e cila në 2009 ka qenë 45.4 për qind, në 2012 30.8 për qind dhe kur 55.3 për qind të papunëve kanë qenë të rinj nga mosha 15-24, i kontribuon më së shumti varfërisë.⁴ Këto të dhëna tregojnë që situata e keqe ekonomike në vend përbën një ambient të përshtatshëm për tensione të mundshme. Për më shumë, duke pasur parasysh persistencën e konflikteve etnike, ekziston rreziku që ankesat ekonomike nuk do të artikulojnë drejt një fokusi ekonomik, por do të shprehen në vija etnike.

Për shkak të këtyre konsideratave, është qenësore që çdo aktor në Kosovë t'i qaset çështje publike nëpërmjet një prizmi të ndjeshëm ndaj konfliktit. Ndjeshmëria ndaj konfliktit është një normë me të cilën operojnë shumë aktorë si agjenci qeveritare dhe jo qeveritare, organizata të shoqërisë civile dhe media të cilat raportojnë në rajone të tilla. Të gjitha këto entitete pajtohen që nëpërmjet adoptimit të një qasje të ndjeshme ndaj konfliktit, ato sigurohen që kuptojnë mirë bashkëveprimin e dyanshëm ndërmjet aktiviteteve dhe kontekstit dhe veprojnë që të minimizojnë efektet negative e të maksimizojnë efektet pozitive të intervenimit në konflikt.⁵

Mediat duhet të tregojnë kujdes të veçantë kur operojnë në një zonë me potencial për konflikt meqenëse veprat e njëanshme nga ana e tyre mund të kenë efekt shumë më të madh sesa ato të organizatave të tjera që operojnë në kushte të tilla. Për më shumë, mediat janë burimi kryesor i informatave edhe për ata që gjenden larg qendrave të mundshme të konfliktit, kështu që roli i tyre është tejet i rëndësishëm. Prandaj, në mënyrë që të mos tensionojnë më tej konfliktet, mediat duhet të jenë të sigurohen që raportimi i tyre të jetë i ndjeshëm ndaj konfliktit dhe objektiv. Kësisoj, mediat duhet të luajnë një rol më të gjerë në këto raste sesa ato luajnë zakonisht në botë. Në këtë rol të zgjeruar, mediat duhet të jenë të kujdesshme në dhënien e informatave të qarta dhe të balancuara rreth konfliktit për të cilin raportojnë. Për më shumë, ato duhet të përpiqen që të paqësojnë konfliktet duke u dhënë aktorëve të ndryshme të konfliktit një platformë në të cilën mund të gjejnë një pajtim të përbashkët. Në anën tjetër, nëse mediat dështojnë në përmbushjen e këtij roli, qoftë duke mos siguruar objektivitet apo duke mos u kujdesur që të anashkalojnë

¹ Ligji për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Komuniteteve në Kosovë i njeh këto komunitete: shqiptarët, serbët, turqit, boshnjakët, goranët, roma, egjiptian dhe ashkali.

² Fondi për të Drejta Humanitare. (2011). Libri i Kujtimeve i Kosovës (1998-2000). Beograd: Fondi për të Drejta Humanitare.

³ Varfëria në konsum në Republikën e Kosovës në vitin 2011, Banka Botërore dhe Agjencia e Statistikave të Kosovës, Mars 2013

⁴ Rezultatet e Anketës së Fuqisë Punëtore 2012 në Kosovë, Agjencia e Statistikave të Kosovës, Shtator 2013

⁵ Konsorciumi për Ndjeshmëri ndaj Konfliktit. I qasur më Mars 16, 2014 nga <http://www.conflictsensitivity.org/content/introduction-0#defining>

gjuhën nxitëse, ato mund të shkaktojnë dëme të pariparueshme ndaj komuniteteve të përfshira në konflikt.

Në Kosovë, mediat duhet të tregojnë kujdes në mënyrë që raportimi i tyre të përmbushë normat e ndjeshmërisë ndaj konfliktit. Nën kushtet e lartpërmendura, është shumë lehtë që një media e papërgjegjshme apo pa eksperiencë të shkaktojë apo eskalojë tensione nëpërmjet mbulimit të papërgjegjshëm të çështjeve të ndjeshme. Kur këtyre faktorëve i shtohen dallimet kulturore që ekzistojnë brenda komuniteteve në Kosovë, roli i mediave si një lehtësues universal bëhet akoma më i rëndësishëm. Prandaj, duke mos i kushtuar rëndësi rrolit të tyre si një lehtësues universal, mediat mund të bëhen bartës të tensioneve ndëretnike, religjioze, politike apo ekonomike.

Për sa i përket të lartpërmendura, ky studim synon të analizojë perceptimin e qytetarëve të Kosovës për sa i përket ndjeshmërisë ndaj konfliktit tek mediat. Kjo është tejet e rëndësishme në mënyrë që të vlerësohen gjasat për një konflikt të shtyrë nga mediat në vend dhe për të vlerësuar opsionet për intervenime në rast të konflikteve të tilla. Për më shumë, studimi synon që të analizojë kornizën ekzistuese ligjore që rregullon mediat rreth këtyre çështjeve dhe të vlerësojë disa probleme të perceptuara nuk janë adresuar nga trupat rregullativ dhe politikat e tyre. Në fund, analiza do të parashtrojë disa rekomandime për zgjidhjen e fushave problematike të mbulimit të temave të ndjeshme ndaj konfliktit nga ana e mediave.

II. METODOLOGJIA

Ky studim analizon perceptimin e publikut rreth ndjeshmërisë të mediave ndaj konfliktit, kornizë rregullative rreth raportimin të ndjeshëm ndaj konfliktit si dhe opinion e ekspertëve ndaj probleme të identifikuara. Më thellësisht, studimi ka synuar të analizojë se sa të ndjeshme ndaj konfliktit janë mediat në Kosovë.

Raportimi i ndjeshëm ndaj konfliktit i referohet praktikës së anashkalimit të përdorimit të gjuhës dhe inkuadrimit konflikt ndjellës nga ana gazetarëve dhe redaktorëve të mediave. Kjo qasje synon që të sigurojë që publiku është mirë i informuar ndërkohë që të sigurojë që raportimi nuk është një pararendës apo shtytës i konfliktit në shoqëri.

Për të adresuar temën e hulumtimit është përdorur metodologji kualitative. Metoda parësore e hulumtimit kanë qenë fokus grupet kualitative me dy moderatorë. Fokus grupet janë organizuar në Prishtinë, Mitrovicë, Gjilan, Gjakovë, Prizren, Leposaviq dhe Zubin Potok me pjesëmarrës të përzier për sa i përket etnisë në secilin rajon. Grupi i synuar kanë qenë pjesëmarrës me shkollim të mesëm ose më lartë, gjini të përzier dhe me profil pune me “kollare blu”. Moshat e përfaqësuara kanë qenë nga mosha e shkollimit post-sekondar deri tek mosha ligjore e pensionimit në Kosovë. Pjesëmarrësit nuk janë paguar për pjesëmarrje në fokus grupe. Fokus grupet janë inçizuar në mënyrë që të analizohen të dhënat, por pjesëmarrësit kanë qenë anonim në mënyrë që të sigurohet një ambient i sigurt për vlerësimin e opinionit personal.

Të dhënat e fokus grupit janë analizuar nëpërmjet një qasje shumë palëshe – vlerësimi i perceptimit individual, vlerësimi i qëndrueshmërisë së opinionit, pajtimi i përgjithshëm i grupit rreth një çështje dhe botëkuptimet të cilat i kanë ndarë të gjithë pjesëmarrësit. Pyetjet për fokus grupe kanë qenë të parapërgatitura, sidoqoftë janë lejuar zgjerime sipas zgjedhjes së moderatorëve.

Hulumtimi sekondar është fokusuar tek korniza ligjore rreth mediave dhe raportimit në Kosovë. Fokus primar i hulumtimit sekondar kanë qenë kornizat ligjore për vendosjen e institucioneve rregullatore dhe vetë-rregullatore të mediave në Kosovë. Për më shumë, të gjitha rregulloret dhe

vendimet e këtyre institucioneve janë vlerësuar si pjesë e rishikimit të provizioneve rreth gjuhës së urrejtjes dhe ndjeshmërisë ndaj konfliktit.

Fokus dytësor i hulumtimit sekondar kanë qenë të gjitha raportet e institucioneve të pavarura rreth mediave në Kosovë. Këto janë: Nations in transit nga Freedom House, Media Sustainability Index nga IREX, Freedom of the Press nga Reporterët pa Kufij, Raportet e Progresit të përgatitura nga Komisioni European dhe Gjendja e Mediave në Kosovë nga INDEP. Një numër i burimeve të treta nga agjenci të tjera gjithashtu janë përdorur gjatë fazës së analizës.

Në fund, për të vlerësuar fushat problematike të gjetura nga analiza janë përdorur intervista gjysmë të strukturuar me publicistë, gazetarë, sociologë, redaktorë si dhe analistë të pavarur. Intervistat kanë synuar që të adresojnë opinionet e ekspertëve ndaj perceptimeve problematike të gjetura nga fokus grupet. Të gjithë intervistuesve u është bërë një listë e pyetjeve të strukturuar me mundësinë e zgjerimit.

III. KORNIZA LIGJORE

Mediat në Kosovë duhet të tregojnë kujdes të veçantë për të siguruar objektivitet dhe anashkalimin e animet në raportim për shkak të larmisë të demografisë së banorëve të vendit. Në një vend i cili ka tetë grupe etnike, tre religjioze dhe shumë pikëpamje politike, mediat duhet të tregojnë kujdes së veçantë në mënyrën se si e strukturojnë raportimin e tyre. Kjo aplikohet veçanërisht në raste të raportimit ndërkulturor, në mënyrë që të mos ndizen mosmarrëveshje apo keqkuptime të cilat mund të shkaktojnë konflikt. Në kushtetutën e Kosovës një gjë e tillë merret parasysh nën kapitullin i cili e vendos lirinë e mediave, provizionet e të cilit e ndalojnë censurën deri në pikën ku intervenimi bëhet i nevojshëm për të ndaluar ndezjen apo provokimin e dhunës në baza racore, nacionale, etnike apo religjioze.⁶ Për më shumë, Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës dhe Komisioni i Pavarur për Media rregullojnë mediat e shkruara dhe të transmetuara respektivisht. Nuk ka trupa zyrtar rregullativ për mediat online, të cilat vazhdimisht gëzojnë lexueshmëri më të lartë në Kosovë, një gjë e cila mund të shkaktojë brenga tani dhe ne të ardhmen.

Komisioni i Pavarur për Media është formuar nga neni 141 i Kushtetutës së Kosovës si një organ i cili licencën dhe rregullon kanalet radio televizive të cilat operojnë në vend. I fuqizuar më tej nga aftësia për të aprovuar akte nënligjore, komisioni ka publikuar një rregullore e cila prek shumë aspekte të punës së mediave audio vizive. Këto akte kërkojnë në veçanti që gjuha e raportimit të mos ketë elemente të gjuhës së urrejtjes apo elementeve që nxisin dhunë. Vetë brenda kodit thuhet se një nga qëllimet kryesore të këtij kodi është parandalimi i problemeve shoqërore nëpërmjet rregullimit të normave të raportimi të mediave audio vizive⁷. Përveç normave të zakonshme të cilat ndalojnë përdorimin e gjuhës diskriminuese apo ndjellëse, një nen brenda kodit merret drejtpërdrejtë me parandalimin e ndjelljes së dhunës nëpërmjet mediave audio vizive. Neni, përveç ndalimit të gjuhës që synon të ndjellë dhunë, urrejtje, revoltë apo rebelim, gjithashtu parashikon kufizimin e pamjeve dhe zërave të cilat mund të çojnë te të njëjtat reagime.⁸ Duke pasur parasysh që përdorimi i pamjeve dhe zërave tendencioze mund të ketë të njëjtin efekt si gjuha e përdorur në rastet e nxitjes së dhunës, përfshirja e këtij aspekti në rregullore nga ana e komisionit është për tu lavdëruar.

Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës është një organizatë joqeveritare e formuar nga bashkimi i disa përfaqësuesve të mediave të shkruara në Kosovë. Qëllimi parësor i kësaj

⁶ Kushtetuta e Republikës së Kosovës neni. 42 § 2

⁷ Kodi i Mirësjelljes për shërbime mediale audio vizuale në Republikën e Kosovës.

⁸ Kodi i Mirësjelljes për shërbime mediale audio vizuale në Republikën e Kosovës. neni. 11.

organizate është rregullimi i operimit dhe sjelljes së mediave të shkruara. Si rrjedhojë, KMSHK ka publikuar Kodin e Mediave të Shkruara të Kosovës, i cili synon të rregullojë çështjet morale, etike dhe profesionale të mediave të shkruara në Kosovë. Sikur në rastin e KPM-së, KMSHK e rregullon gjuhën e raportimit nëpërmjet Kodit të Sjelljes, si mënyrë e uljes së mundësive të konfliktit për shkak të përdorimit të gjuhës së papërshtatshme gjatë raportimit.

Meqenëse gjuha nuk është i vetmi faktor i cili mund të ndezë konflikte apo urrejtje, KMSHK gjithashtu mbikëqyr objektivitetin e mediave. Prandaj, KMSHK obligon mediat që të sigurohen që marrin të gjitha hapat e mundshëm në mënyrë që të mos shkaktojnë urrejtje ose pabarazi nëpërmjet trajtimit të njëanshëm të individëve apo grupeve në baza të etnisë, religjionit, gjnisë, racës, martesës, moshës apo trupit dhe shëndetit; apo përdorimit të frazave nënçmuese me qëllim të dëmtimit apo kërcënimit të një individi apo grupi për arsyet e lartpërmendura.⁹ Gjithashtu, për shkak të natyrës të ndjeshme të raportimit ndër-kulturor, Kodi parasheh që referenca e përkatësisë etnike, racore, religjioze, gjinore, orientimi seksual apo gjendja fizike dhe mendore e një individi nuk do të merren parasysh në raportim përderisa një gjë e tillë nuk është drejtpërdrejtë relevante për të përfunduar raportimin.¹⁰

Raportimi i krimit përbën një aspekt tjetër të ndjeshëm ndër-kulturor dhe me adoptimin e Udhëzuesit për Kodin e Mediave të Shkruara të Kosovës, një gjë e tillë është adresuar si duhet. Sipas udhëzuesit, raportimi për krim duhet të bëhet pa përshkruar përkatësinë etnike, religjioze apo ndonjë përkatësi tjetër të keqbërësit të dyshuar nëse informata nuk është drejtpërdrejtë e lidhur me rastin.¹¹ Për shkak se shumë konflikte në zona të botës të cilat janë të larmishme për sa i përket kulturave shpesh shkaktohen nga raportimi i paragjykuar ndaj përkatësisë së një individi apo grupi, është shume me rëndësi që një gjë e tillë të specifikohet te kodi.

Për shkak të rritjes së shpejtë të mediave digjitale, apo mediave online, nuk akoma një trup rregullativ i cili i mbikëqyr këto media. Kjo krijon një vakum për sa i përket rregullimit të një burimi kaq të rëndësishëm të lajmeve. Në mënyrë që të adresojë këtë vakum, dhe të përmirësojë Kodin në përgjithësi, KMSHK ka publikuar një dokument shtesë ndaj Kodit të Mediave të Shkruara si një mënyrë që të mbulojë mediat online në Kosovë nën ombrellën e saj. Udhëzuesi i Kodit është publikuar shtatë vite pas implementimit të kodit origjinal dhe ka sjellë shumë përmirësime të cilat kanë synuar të promovojnë raportim të ndjeshëm ndaj konfliktit në media të shtypura dhe digjitale. Meqenëse seksionet e komenteve në media online përbëjnë një pjesë qenësore të portaleve të lajmeve, udhëzuesi i KMSHK gjithashtu pa paraparë rregullimin e këtij aspekti të rëndësishëm. Prandaj, nuk është çudi që shumica e neneve në udhëzues trajtojnë çështjen e komenteve në portale. Brenda udhëzuesit thuhet se është detyrë e portalit të internetit që të monitorojë dhe largojë çfarëdo komenti nga seksioni i komenteve i cili ka përmbajtje që mund të ndezë në çfarëdo forme gjuhë të urrejtjes, përdorim të gjuhës fyese apo akteve kriminale.¹² Duke drejtuar një pjesë të përgjegjësisë të publikimit të komenteve tek vet mediat, KMSHK ka siguruar që një media online, e cila i ka kapacitetet më të mëdha për të monitoruar dhe rregulluar portalin e saj, të jetë e angazhuar aktivisht dhe profesionalisht në largimin e komenteve nxitëse apo fyerëse.

Për far të keq, siç është rasti me shume ligje në Kosovë, edhe këto nuk implementohen si duhet. Në rastin e udhëzuesit të KMSHK, një gjë e tillë mund të provohet vetëm duke shfletuar seksionin e komenteve tek portalet online në Kosovë dhe duke parë gjuhën e papranueshme e cila gjendet në to.

⁹ Kodi Etik i mediave të shkruara të Republikës së Kosovës neni. 3, § 2.

¹⁰ Kodi Etik i mediave të shkruara të Republikës së Kosovës neni. 3, § 3.

¹¹ Udhëzimi i Kodit Etik i mediave të shkruara të Republikës së Kosovës neni. 3.

¹² Udhëzimi i Kodit Etik i mediave të shkruara të Republikës së Kosovës, Udhëzimet për Gazetari Online, neni. 2.

IV. PERCEPTIMI – TË GJETURAT E PËRGJITHSHME

Kosova gëzon një skenë të populluar të mediave, me një numër të lartë të transmetuesve të licencuar, mediave të shkruara dhe atyre online. Numri i transmetuesve të licencuar në Kosovë është 167, me 21 televizione, 83 radio stacione, 14 operator kabllovik dhe 49 ofruesve të shërbimit programatik që transmetojnë nëpërmjet rrjetit kabllovik.¹³ Nga 21 televizionet, tre transmetojnë në të gjithë Kosovën: Radio Televizioni i Kosovës (RTK), i cili përfshin katër stacione, njëra nga të cilat në Serbisht si dhe transmetuesit privat – Radio Televizioni 21 (RTV21) dhe Kohavizion (KTV). Në Kosovë ka gjithashtu tetë gazeta kombëtare, njëra nga të cilat në Serbisht, me një numër të paditur por të lart të mediave të shtypura lokale. Për më shumë, përveç mediave Kosovare, ka një numër të lartë të transmetuesve nga Serbia të cilët ndiqen kryesisht nga popullata serbe në Kosovë.

Ky numër i lartë i mediave ofron një gamë të gjerë të raportimit mbi çfarëdo çështje, qoftë kombëtare, ndërkombëtare apo lokale. Në një ambient kaq të gjerë të raportimit, kualiteti, thellësia dhe nuanca e përgatitjes së një storje ndryshojnë nga media në media. Si rezultat, perceptimi publik për sa i përket mbulueshmërisë dhe sasisë së informatave për çfarëdo çështje, veçanërisht për sa i përket ndjeshmërisë ndaj konfliktit, nuk është i njëtrajtshëm.

Fokus grupet e mbajtura në të gjithë Kosovën tregojnë se qytetarët nuk mund të identifikojnë të gjitha grupet etnike që jetojnë në rajonet e tyre. Kur u është kërkuar që të numërojnë të gjitha entitetë, pjesëmarrësit në fokus grupe kanë ngecur në zgjedhjen e një liste përfundimtare të të gjithë etnive që jetojnë në një zonë të caktuar. Ky është një indikator që niveli i informatave të në dispozicion për grupet etnike është i mangët.

Mungesa e informatave për sa i përket etnive të ndryshme që jetojnë në një rajon gjithashtu i aplikohet edhe informacionit të transmetuar nga mediat për sa i përket religjionit. Kjo ka qenë më e theksuar tek pjesëmarrësit shqiptar të fokus grupeve për sa i përket përkatësisë religjioze të shqiptarëve që jetojnë në rajonet e tyre, si dhe përkatësisë fetare të grupeve më të vogla etnike.

Kur pjesëmarrësit janë pyetur se cilat media preferojnë ti ndjekin, konsensusi i përgjithshëm ka qenë se për storie nacionale, tre televizionet nacionale kanë qenë zgjedhja e preferuar. Pjesëmarrësit nga veriu i Kosovës kanë përmendur media të bazuara në Serbia si buimin parësor të informatave, së bashku me një numër të kufizuar të mediave lokale në veri. Pas vlerësimit parësor, ka qenë e qartë se ka pasur rezerva për sa i përket besueshmërisë së transmetuesit publik, RTK. Fokus grupi e mbajtur në Prishtinë, sidoqoftë, ka theksuar se burimi parësor i informatave mbeten mediat kombëtare dhe portalet online, pa fokus në media lokale. Pjesëmarrësit në fokus grupe gjithashtu kanë përmendur portale online si një burim i informacionit, një perceptim i cili ka qenë i ndarë kryesisht nga pjesëmarrësit e moshave më të reja. Sidoqoftë, pjesëmarrësit që kanë cekur portalet online si burime të tyre të informacionit gjithashtu kanë shtuar se ata zakonisht kërkojnë t'i vërtetojnë të dhënat e mara nëpërmjet mediave të besueshme. Sipas tyre, kjo ndodh meqenëse ata nuk i kanë perceptuar portalet online si të besueshme.

Pjesëmarrësit gjithashtu janë përgjigjur pozitivisht kur janë pyetur nëse ata ndjekin storje nga gazetarë specifik kur lexojnë mediat e tyre të preferuara. Pjesëmarrësit kanë treguar se ata kërkojnë gazetarë specifik kryesisht për shkak se edhe brenda një medie, ata kanë perceptuar se disa gazetarë janë më të besueshëm. Ky perceptim i është aplikuar edhe mediave kombëtare edhe atyre lokale, një gjë që tregon se qytetarët besojnë që ka heterogjenitet të besueshmërisë edhe brenda një mediumi, ku një storje është më e besueshme sesa ndonjë tjetër. Sipas pjesëmarrësve, një gjë e tillë ndodh për shkak të preferencave redaktorialë të këtyre mediave dhe

¹³ Komisioni i Pavarur për Media. (2012). Raporti vjetor i punës për vitin 2012, Prishtinë/Priština, I qasur më mars 15, 2014, nga <http://kpmks.org/materiale/dokument/1369054659.2327.pdf>

për shkak se disa gazetarë duket që mbajnë integritetin profesional pa marrë parasysh politikave redaktoriale të mediave për të cilat punojnë. Për më shumë, kur janë pyetur nëse ndjekin media të komuniteteve të tjera, pjesëmarrësit të moshave më të vjetra janë përgjigjur pozitivisht. Një gjë e tillë është koncentruar tek pjesëmarrësit shqiptar të cilët ndjekin media serbe dhe turke dhe pjesëmarrësit jo shqiptar dhe jo serb të cilët ndjekin media shqiptare dhe serbe njëkohësisht. Pjesëmarrësit serb nga veriu i Kosovës nuk kanë treguar një orvatje të tillë si rezultat i barrierës gjuhësore dhe mungesës së mbulueshmërisë së transmetimit të mediave shqiptare në veri të Kosovës.

Perceptimi i qytetarëve rreth pranisë së konfliktit ndëretnik ka qenë pjesë e vlerësimit të nevojshëm për të substancializuar nivelin e ndjeshmërisë ndaj konfliktit të mediave në Kosovë. Kur janë pyetur nëse mendojnë se ka konflikt midis etnive në qytetet apo rajonet e tyre, pjesëmarrësit nuk kanë treguar ndonjë prani të ndjeshme të konfliktit. Sidoqoftë, pjesëmarrësit shqiptar kanë theksuar se ndërkohë që marrëdhëniet me etnitë jo-serbe janë të mira, marrëdhëniet me serbët janë të pakta dhe sporadike. Përgjigjet e pjesëmarrësve nga veriu i Kosovës gjithashtu kanë shfaqur një barrierë midis dy etnive kryesore, si imagjinare po ashtu edhe funksionale. Megjithatë, ata gjithashtu kanë treguar që nuk ka ndonjë konflikt të pranishëm për momentin për sa i përket marrëdhënieve ndëretnike, por probleme të përgjithshme ekonomike. Për fund, nuk ka ndonjë indikacion që ndonjë religjion ka qenë fusha e fokusit, sidoqoftë, pyetje specifike për të cilat do të elaborohen më vonë në këtë punim, kanë treguar se një grup fetar është ndier i mohuar.

Pyetjet e përgjithshme kanë treguar se qytetarët kanë një botëkuptim të mirë të sferës së mediave. Për më shumë, ata kanë qenë të informuar mirë me ngjarjet e fundit dhe kanë pasur një kuptim të mirë të mediave dhe funksionit të tyre si dhe stafit të tyre. Sidoqoftë, informatat rreth përbërjes etnike dhe fetare të lokaliteteve të tyre kanë qenë të mangëta, ku indikohet se ka një mungesë të përgjithshme të informacionit për këto çështje në mediat në Kosovë. Për shkak të faktit që pjesëmarrësit kanë thënë se mediat mbeten mënyra kryesore e informimit, kjo tregon që mediat në Kosovë nuk kanë qenë të suksesshme në prurjen e këtyre informatave tek lexuesit.

V. MEDIAT, ETNITË DHE MBULUESHMËRIA – PERCEPTIMI PUBLIK

Perceptimi publik i qytetarëve rreth bashkëqytetarëve të tyre nga etnitë e tjera në zona që kanë pasur konflikt ndëretnik është subjekt i përqendërimit të vazhdueshëm. Në 15 vitet e fundit, resurse të konsiderueshme janë investuar për të siguruar paqen nëpërmjet mirëkuptimit. Një nga shtyllat kryesore të ndërtimit të paqes mbeten mediat. Me qasje direkte tek pjesë të konsiderueshme të popullatës, mediat janë në një pozitë të mirë për të mbështetur përpjekjet për stabilitet dhe siguri. Në një shtet me grupe të shumta etnike dhe një të kaluar të dhunshme, duhet treguar kujdes i madh nga mediat kur mbulojnë çështje të ngarkuara emocionalisht. Dështime në këtë aspekt rrezikojnë rritjen e tensioneve. Marsi i 2004 ka qenë një nga rastet kur mediat kanë kontribuar në eskalimin e konfliktit, ku një konsensus i përgjithshëm është se ato nuk kanë treguar vetëpërmbytje në raportim.¹⁴ Pjesëmarrësit shqiptar dhe jo-serb, sidoqoftë, kanë treguar qartë se ata nuk besojnë se një ndodhi e tillë do të mund të ndodhë më.

Kur janë pyetur nëse besojnë se informatat rreth etnive tjera në media e tyre respektive janë të mjaftueshme, pjesëmarrësit në fokus grupe janë përgjigjur pozitivisht. Sidoqoftë, të dhëna të

¹⁴ A. Ahmeti, Gazetar, Tribuna. Intervistë individuale INDEP, mars 12, 2014. I. Mushkolaj, Kryetar, KMSHK, Intervistë individuale INDEP, mars 14, 2014.

monitorimit tregojnë qartë se storiët për etni jo-shqiptarë në gazetën kombëtare janë të pakta, kur vetëm 149 storië për etni të tjera janë gjetur në një periudhë 45 ditore.¹⁵ Kur janë ballafaquar me këtë fakt, pjesëmarrësit shqiptarë në fokus grupe kanë thënë se janë të pajtimit që të mos ketë shumë raportim për minoritete në media shqiptare meqenëse mediat shqiptare duhet të fokusohen tek etnia mazhoritare. Për më shumë, pjesëmarrësit shqiptarë në fokus grupe gjithashtu kanë theksuar se minoritetet kanë mediat e tyre lokale si dhe seksione të lajmeve dhe emisioneve për ta në RTK. Pjesëmarrësit serbë në veri sidoqoftë kanë thënë se nuk kanë qasje në media shqiptare në komunat e tyre dhe që ndjekin kryesisht media nga Serbia. Pjesëmarrësit jo-serbë dhe jo-shqiptarë kanë treguar se janë kryesisht të kënaqur me burimet e lajmeve në gjuhët e tyre dhe që transmetuesi publik mbulon këtë aspekt.

Kur janë pyetur nëse, në storiët rreth etnive të tjera, pjesëmarrësit mbajnë në mend ndonjë storië që i ka acaruar, përgjigjet kanë qenë të përziera. Pjesëmarrësit kanë treguar që ka një ndryshim në mbulueshmëri ndërmjet mediave lokale dhe kombëtare.

Pjesëmarrësit shqiptarë kanë indikuar që shumica e raportimit për komunitetin serb në media shqiptare fokusohet kryesisht rreth bisedimeve Prishtinë – Beograd. Ky raportim është shtyrë nga mediat kombëtare dhe perceptohet të jetë kryesisht i paanshëm; sidoqoftë, pjesëmarrësit shqiptarë kanë indikuar që perceptimi i tyre është se media diktojnë se janë duke u bërë shumë lëshime për anën serbe në bisedime. Pjesëmarrësit serbë në fokus grupe gjithashtu kanë thënë se raportimi për bisedime ka pasur përparësi në këtë aspekt. Ata gjithashtu kanë pranuar ka potencial për ndezje të konfliktit për shkak të mënyrës se si media të ndryshme i interpretojnë bisedimet dhe për shkak të perceptimit të mungesës së objektivitetit rreth raportimit të kësaj çështje. Përveç kësaj, rasti i marsit 2004 është theksuar nga pjesëmarrësit serbë si një rast kur mediat kanë pasur rol në ndezjen e konfliktit të motivuar etnikisht. Pjesëmarrësit shqiptarë gjithashtu kanë treguar se sipas tyre, media kombëtare janë shumë të kujdesshme kur raportojnë për çështje ndëretnike, duke thënë se ata besojnë se një gjë e tillë ndodh si pasojë e ndodhive të marsit 2004.

Pjesëmarrësit romë në fokus grupe kanë shënuar se stereotipat akoma janë të pranishme kur raportohet për minoritetin e tyre. Ngjashëm, etnitë e tjera jo-shqiptarë kanë treguar se ka raste të izoluara të storiëve me mundësi për të ndezur konflikt në media shqiptare në disa raste. Një rast i tillë ka qenë mbulimi i kërkesës së disa grupeve në Prizren për të amendamentuar logon e komunës. Logoja e propozuar e komunës së Prizrenit do të përfshinte një vizatim të Shtëpisë së Prizrenit, një simbol i lëvizjes së pavarësisë së shqiptarëve të Kosovës si dhe datën e kësaj lëvizje, pra 1878. Sipas pjesëmarrësve, kërkesa për heqjen e datës është bërë vetëm për arsye vizuale, sidoqoftë, media e kanë mbuluar si një orvatje nga grupet minoritare për të anashkaluar simbole specifike shqiptare. Sidoqoftë, grupet kanë treguar se një gjë e tillë është bërë si pasojë e mungesës së profesionalizmit nga mediat dhe jo si pasojë e një tentimi të qëllimshëm për të portretizuar etnitë jo-shqiptarë negativisht.

Pjesëmarrësit në fokus grupe gjithashtu kanë treguar që ndërsa besimi i tyre është se mediat serioze kryejnë një punë të mirë për sa i përket raportimit të këtyre çështjeve, media e skajshme dhe rozë nuk janë aq të kujdesshme. Pa specifikuar raste të veçanta, ka pasur një pajtim të përgjithshëm në mes pjesëmarrësve që shtypi rozë fokusohet në raportim sensacionalist i cili mund të shpie në konflikt. Sidoqoftë, pjesëmarrësit në fokus grupe gjithashtu kanë vënë re që raportimi i tillë mund të dallohet lehtë dhe besojnë që nuk përbën ndonjë rrezik.

Kur pjesëmarrësit shqiptarë janë pyetur nëse ndjekin mediat serbe në vend, pak nga ta janë përgjigjur pozitivisht. Për më shumë, pak pjesëmarrës nga fokus grupet serbe kanë treguar që

¹⁵ Instituti për Politika Zhvillimore. (2013). Meidat e shkruara dhe minoritetet në Kosovë: Analizë e mbulueshmërisë.

lexojnë mediat shqiptare. Të tërë pjesëmarrësit që ndjekin mediat serbe janë pajtuar që mbulimi ka qenë negativ dhe ka ndjellë konflikt, në opinion më i spikatur tek pjesëmarrësit nga jugu i Mitrovicës. Një numër i pjesëmarrësve serb nga veriu i Kosovës kanë treguar të njëjtin opinion. Prandaj, ndërkohë që mediat serbe akoma u referohen shqiptarëve me terme përbuzëse, serbet janë të besimit që media shqiptare automatikisht tentojnë të fajësojnë serbët në cilindo rast të mundshëm.

Të gjeturat e përgjithshme të fokus grupeve duket së tregojnë që nuk ka një opinion homogjen rreth ndjeshmërisë ndaj konfliktit tek mediat në Kosovë. Së pari, ka një dallim në perceptimin e kujdesit të mbulimit të çështjeve ndëretnike në mes të mediave të besueshme lokale dhe kombëtare në një anë dhe atyre margjinale dhe shtypit rozë në anën tjetër. Mediat kombëtare shqiptare perceptohen të jenë relativisht të drejta dhe të kujdesshme në raportimin e çështjeve ndëretnike nga të gjitha etnitë përpos serbëve në veri të Kosovës. Disa pjesëmarrës serb të fokus grupeve në veri të Kosovës i perceptojnë mediat shqiptare si të anuara kundër serbëve dhe mediat serbe si më të drejta, në mos më shumë të ndjeshme ndaj konfliktit. Ka pasur një konsensus të përgjithshëm që nuk është përdorur gjuhë e ngarkuar emocionalisht në rastet e pakëta kur është raportuar për minoritetet dhe këto të fundit nuk janë ndier të nxitura nga raportimi. Kjo gjetje e përgjithshme i është aplikuar vetëm fokus grupeve në jug të Kosovës, ndërkohë që perceptimi i pjesëmarrësve serb në veri të vendit reflekton se ata akoma ndiejnë që mediat shqiptare anojnë kundër përfaqësuesve të etnisë serbe.

Sidoqoftë, mungesa e mbulueshmërisë gjithashtu përbën problem në vete. Siç është treguar më lartë, mbulimi i minoriteteve në vend mbetet i ulët. Kjo mungesë e raportimi tanimë ka ndikuar negativisht në njohuritë e përgjithshme të popullatës rreth përbërjes etnike dhe fetare të rajoneve të tyre. Një gjë e tillë mund të ketë efekt negativ në marrëdhëniet ndëretnike duke pasur parasysh që mungesa e informatave mund të shpie te thellimi i ndarjeve ekzistuese në mes të grupeve të ndryshme etnike. Siç është shprehur një pjesëmarrës nga Leposaviqi: "Ne mund të flasim vetëm nga këndvështrimi ynë, ne nuk kemi qasje në media shqiptare, e në rastet kur kemi qasje nuk ka përmbajtje në serbisht që ne të mund t'i kuptojmë. Ne mund të flasim vetëm për informacionin që kemi në mediat tona." Pjesëmarrësit janë shprehur që komunikimi në mes etnive ndodh sipas nevojës dhe nuk ka komunikim të rregullt, me përjashtim të pjesëmarrësve në Prizren.

Mungesa e mbulueshmërisë të minoriteteve gjithashtu është funksion i dy fenomeneve. Së pari, mediat private në gjuhën shqipe qartë tregojnë se nuk kanë interes të raportojnë mbi dhe për minoritetet. Kjo ndodh për shkak se publiku shqiptar nuk është i interesuar të informohet rreth këtyre çështjeve dhe lexueshmëria / shikueshmëria nga publiku jo-shqiptar thajse nuk ekziston.¹⁶ Një gjë e tillë më tej mbështetet nga të gjeturat e fokus grupeve, ku pjesëmarrësit shqiptar tregojnë qartë që nuk presin raportim të tillë. Për pjesëmarrësit serb nga veriu një problem i tillë nuk ekziston, duke pasur parasysh faktin se ata ndjekin mediat serbe apo lokale. Për më shumë, barrierat gjuhësore gjithashtu shkakton një problem të konsiderueshëm, meqenëse raportimi në shumë gjuhë është i kushtueshëm. Për më tepër, kapacitetet e brendshme për të raportuar nga regjione të ndryshme të banuara nga grupet etnike është i shtrenjtë, meqenëse kostot e korrespondentëve janë të larta dhe interesi i publikut i ulët.

Pa marrë parasysh të lartpërmendurat, pjesëmarrësit e fokus grupeve kanë treguar që ka një mungesë konsistente të mbulimit të çështjeve të vazhdueshme nga fundi i luftës. Raportimi për persona të zhdukur dhe varreza masive mbetet i pakët. Raportimi për çështje të pazgjdhura nga e kaluara si viktimat e luftës, personat e gjymtuar dhe grupe të tjera të ndikuara nga lufta është i rrallë. Ndërkohë që këto çështje nuk shkaktojnë konflikt, sipas disa grupeve, ato i lënë të

¹⁶ A. Ahmeti, mars 12, 2014.

pazgjidhura dhe të pa debatuar tensionet dhe fusha të konfliktit nga e kaluara.¹⁷ Kjo përbën një problem afatgjatë, kur kemi parasysh që një zgjidhje e qëndrueshme ndaj problemeve ndëretnike nuk mund të arrihet pa filluar debatin dhe zgjidhur probleme të mbetura nga e kaluara.

VI. ETNIA KRYESORE – KONFLIKTE TË INJORUARA

Pas luftës, shumica e mundit rreth ndërtimit të paqes dhe sigurisë u është kushtuar pajtimit të popullatës serbe dhe shqiptare në Kosovë. Deri tek lufta, popullata shqiptare është paraqitur si një grup i unifikuar dhe për shkak të shtytjes së përbashkët për pavarësi, ndasitë ndër-shqiptare thuajse nuk janë vënë re. Sidoqoftë, vite pas përfundimit të luftës, larmia e grupit më të madh etnik ka filluar të bëhet më e qartë, ndërkohë që problemet ndër kufitare bëhen më pak të rëndësishme.

Shqiptarët e Kosovës përbëhen nga një numër i ndryshëm i besimeve politike dhe fetare, ndërmjet tjerash. Shumica e shqiptarëve në Kosovë janë mysliman, ndërkohë që grupi i dytë më i madh fetar janë katolikët. Sidoqoftë, grupe të tjera fetare dhe jo-deiste ekzistojnë dhe përfaqësojnë thuajse 5% të popullatës në vend.¹⁸ Për më shumë, dallimet rajonale gjithashtu ekzistojnë dhe shpesh shfaqen përgjatë vijave politike. Aktualisht, tetë grupe politike janë të përfaqësuara në Kuvendin e Kosovës, ndërkohë që 13 të zgjedhur nuk kanë përkatësi politike.¹⁹ Lista e përgjithshme e partive politike në vend, sidoqoftë, është shumë më e madhe.

Të dhënat më lartë tregojnë që ndërkohë që shumica e fokusit është vënë në marrëdhëniet ndëretnike, pak rëndësi i është dhënë adresimit të larmisë së opinioneve të etnisë shumicë. Në fakt, ndërkohë që raportimi për çështje ndëretnike nga mediat kryesore është kryesisht i ndjeshëm ndaj konfliktit, raportimi për çështje që ndikojnë komunitetin shumicë janë krejtësisht të ndryshme.

Pjesëmarrësit shqiptarë në fokus grupe kanë treguar që ata besojnë se shumë media përfaqësojnë një grup politik ose biznesor apo tjetrin. Kur pjesëmarrësit janë pyetur nëse ju kujtohet një storje që u ka penguar dhe që nuk është lidhur me marrëdhënie ndëretnike, gati të gjithë pjesëmarrësit kanë përmendur nga një storje. Shumica e storjeve të cilat kanë ndikuar në konflikt të brendshëm për palën shqiptare janë bazuar në raportime për fe apo për politikë.

Rishtazi, Kuvendi i Kosovës ka draftuar një ligj mbi zbritjen e ndotjes së zhurmës në Kosovë. Ky ligj gjithashtu ka paraparë vendosjen e rregullave për kontrollin e zhurmës ndaj xhamive në vend, duke caktuar një limit të volumit që mund të përdorin këto xhami. Sidoqoftë, sipas pjesëmarrësve në fokus grupe, media kanë portretizuar ligjin si një ligj i cili për synim pa pasur kufizimin e lirive fetare të popullatës kryesisht myslimane. Sipas pjesëmarrësve në fokus grup, mbulimi i kësaj çështje nga mediat nuk e ka bërë mjaftë të qartë që ligji ka synuar që të ulë volumin e thirrjes për lutje në xhami, dhe jo largimin e saj. Si rezultat, një situatë potencialisht e rrezikshme është krijuar brenda popullatës shumicë.

Në anën tjetër, pjesëmarrës në fokus grupe kanë thënë se mbulimi i kërkesës për dorëheqje të rektorit të Universitetit të Prishtinës ka qenë shumë kundërthënë. Më herët në 2014, një nga gazetatat kombëtare në Kosovë ka raportuar që rektori i Universitetit të Prishtinës ka botuar artikuj shkencor në publikime të rreme, duke vënë në pyetje integritetin e tij akademik.²⁰ Këta artikuj

¹⁷ N. Ahmetaj, Drejtorëshë Ekzekutive, Centre for Research, Documentation and Publication, Intervistë individuale INDEP, mars 11, 2014.

¹⁸ Agjencia Statistikore e Kosovës. Regjistrimi i Popullsisë.

¹⁹ Kuvendi i Republikës së Kosovës Përfaqësia Kombëtare e Republikës së Kosovës. I qasur më mars 15, 2014, nga <http://www.kuvendikosoves.org/?cid=2,107>

²⁰ Krasniqi, B. (2014, January 23). Kërkohet dorëheqja e rektorit Gashi.KohaDitore, pp. 1.

kanë shpjer në protesta, kërkesa e të cilave ka qenë dorëheqja e rektorit dhe stafit tjetër akademik të cilat kanë pasur të njëjtin problem. Kur pjesëmarrësit janë pyetur se cili ka qenë problemi me mbulimin e krizës të Universitetit të Prishtinës, përgjigjet kanë qenë të përziera. Disa pjesëtarë kanë thënë se ata besojnë që disa media kanë mbështetur rektorin, i cili perceptohet të jetë i anuar me partitë politike në pushtet. Sidoqoftë, disa pjesëmarrës të tjerë kanë thënë se ky anim ka qenë i arsyeshëm dhe kanë vënë në dyshim saktësinë e akuzave. Të njëjtit pjesëmarrës gjithashtu kanë thënë se gjuha e gazetës e cila ka raportuar për këtë problem ka pasur për synim nxitjen e protestave dhe ka qenë e njëanshme.

Të dyja këto raste tregojnë që mediat, ndërkohë që janë të kujdesshme kur raportojnë për çështje ndëretnike, nuk e tregojnë të njëjtin nivel të kujdesit kur i mbulojnë çështjet intra etnike. Gjuha e përdorur mbetet kryesisht e njëanshme dhe shumica e pjesëmarrësve besojnë që mediat mbështesin njërin apo tjetrin grup.

Këto të gjetura tregojnë se në një nivel apo tjetrin, gjuhë e cila mund të dërgojë në konflikt përdoret nga mediat në Kosovë. Kur pjesëmarrësit janë pyetur nëse e perceptojnë që një gjë e tillë bëhet me qëllim apo jo, përgjigjet gjithashtu kanë qenë të përziera. Pjesëmarrësit në fokus grupe kryesisht kanë thënë se janë dy çështje të cilat ata besojnë mund të çojnë në gjuhë apo raportim konflikt ndjellës. Së pari, ata kanë shpjeguar se besojnë që politikën redaktoriale që synojnë rritjen e publikut të tyre nëpërmjet storieve sensacionale të influencuar nga pronarë medial të panjohur është një nga arsytet. Ata gjithashtu kanë përmendur mungesën e kapaciteteve për të mbuluar storiet me kujdes nga ana e gazetarëve.

Besimi i dytë i pjesëmarrësve arsyetohet kryesisht nga studimet e mëhershme për gjendjen e mediavë në Kosovë. Mediat në Kosovë nuk i kanë kapacitete për të siguruar mbulueshmëri kualitative, siç dëshmohet nga mos implementimi i standardeve të gazetarisë profesionale, si verifikimi shumë burimor, bilanci i opinioneve në storje, etj.²¹ Në anën tjetër, ndikimi politik për shkak të afërsisë së interesave politike dhe biznesore gjithashtu përbën presion mbi media, veçanërisht ndërkohë që të ardhurat nga reklamat që varen nga bizneset me lidhje të ngushta me politikën janë të domosdoshme për mbijetesën e mediave.

Për më shumë, përfaqësues të mediave tregojnë që ka një tendencë të qëllimshme nga mediat për të strukturuar storiet në një mënyrë të tillë që të ngjallin debat.²² Sipas këtyre përfaqësuesve, një qasje me direkte ndaj mbulueshmërisë së disa çështjeve kundërthënëse siguron që publiku mbahet i informuar për këto çështje. Megjithatë, një qasje e tillë përbën problem në vete meqenëse struktura sensacionale e storieve kundërthënëse, pa përdorimin e një qasje të ndjeshme ndaj konfliktit mund të ketë pasoja negative.

Sidoqoftë, nuk ka tregues që thonë që mbulueshmëria thyen politikën për raportimin e mediave dhe kodet profesionale të rregullatorëve të mediave. Siç është treguar më lartë, KPM dhe KMSHK vazhdimisht monitorojnë mediat kodeve dhe rregullave profesionale për fyerje, gjuhë të urrejtjes dhe kritere të tjera. Deri tani, këto organizata nuk kanë treguar ndonjë nivel të brengës për sa i përket mbulimit të çështjeve ndëretnike. Sidoqoftë, mbulimi i ndjeshëm ndaj konfliktit për sa i përket çështjeve ndëretnike është një orvatje delikate dhe jo e drejtpërdrejtë, dhe për shkak të mungesave në kapacitete, aftësia e KPM dhe KMSHK për të intervenuar në këto raste është e vogël.

Profesionistët medial gjithashtu theksojnë se mbulimi i anuar rritet gjatë kohës para dhe pas zgjedhore.²³ Kosova ka mbajtur zgjedhjet lokale në nëntor 2013, ndërkohë që 2014 është viti i zgjedhjeve parlamentare me gjasa të larta për zgjedhje të parakohshme.²⁴ Analistë dhe

²¹ Gashi, K., & Qavdarbasha, SH. (2012). Gjendja e Mediave në Kosovë. Prishtinë, KS: Instituti për Politika Zhvillimore.

²² A. Ahmeti, mars 12, 2014.

²³ A. Ahmeti, mars 12, 2014. I. Mushkolaj, mars 14, 2014.

²⁴ Krasniqi, B. (March 5, 2014). *Zgjedhjet e parakohshme pa rrëzimin e Qeverisë*. Koha Ditore.


profesionistë të mediave pajtohen se për shkak të numrit të shumtë të aktiviteteve politike gjatë kësaj periudhe si dhe kapaciteteve të limituara për të mbuluar të gjitha palët, krijohet një perceptim i anshmërisë. Megjithatë, ata gjithashtu theksojnë se një numër i madh i mediave kanë tendenca të fokusohen tek partitë më të mëdha.

Pa marrë parasysh shkaktarët kompleks të mbulimit me potencial për pasoja negative nga mediat vendore, problemi mbetet që larmitë intra-etnike nuk janë duke u adresuar si duhet nga mediat. Kjo është një çështje me rëndësi të lartë meqenëse mbulimi sensationalist i çështjeve kundërthënëse mund të shkaktojë konflikt. Një gjë e tillë është akoma më e rëndësishme kur konsiderohet se gjendja ekonomike në vend mund të shpie më tej në konflikt. Si rezultat, është jashtëzakonisht e rëndësishme që mediat në Kosovë të jenë në dijeni të këtyre problemeve dhe të marrin një qasje të ndjeshme ndaj konfliktit kur raportojnë këto probleme.

VII. PËRFUNDIMET

Perceptimet mbi ndjeshmërinë e mediave ndaj konflikteve kanë dalë të jenë të përziera në përgjithësi. Nuk ekziston perceptimi i ekzistimit të një tendence sistematike nga mediat (lokale dhe qendrore) që të portretizojnë grupe të veçanta në një dritë konflikt nxitëse, të paktën kështu është perceptuar nga komunitetet jo-serbe. Ka, megjithatë, raste të izoluara ku gjuha ose metoda e raportimit e mediave është prezantuar në asi mënyre me të cilën mund të jetë potencialisht konflikt nxitëse. Kjo aludon tek gjendja jo e kënaqshme e autoriteteve rregullative për të mbikëqyrur dhe vepruar në kësi çështje. Përveç kësaj, kjo po ashtu potencialisht tregon mungesën e kapacitetit profesional të mediave për t'i marrë parasysh plotësisht qasjet e ndjeshme ndaj konflikteve, gjatë raportimit. Përveç mungesës së monitorimit në disa raste, trupat rregullatorë po ashtu shfaqin një mungesë të zbatimit, veçanërisht KMSH, e cila nuk ka fuqi ligjore për të intervenuar në operimin e mediave të shkruara. Për ta zbutur këtë çështje, KMSH ishte dashur të fuqizohet në një mënyrë të ngjashme si KPM, që do të thotë që KMSH duhet të ketë fjalë në funksionimin e mediave të shkruara, veçanërisht nëse ato media kanë histori të përfshirjes së përmbajtjes konflikt nxitëse në lajmet e tyre.

Vetë mediat mbajnë përgjegjësinë më të madhe kur bëhet fjalë për përmbajtjen e tyre, dhe nëse ajo përmbajtje është brenda kornizës së ndjeshmërisë ndaj konflikteve. Duke e marrë parasysh mënyrën se si funksionojnë trupat rregullatorë, mediat mund potencialisht të shkaktojnë trazira me anë të raportimit konflikt nxitës, edhe në raste kur ka monitorim të qëndrueshëm nga ana e KPM dhe KMSH. Mbase ekziston një periudhë kohore e cila e dikton shpejtësinë me të cilën trupat rregullatorë mund të veprojnë, dëmtimi i shkaktuar nga raportimi i mediave mund të jetë i konsiderueshëm. Prandaj, mediat e ndryshme duhen të jenë veçanërisht të kujdesshme kur ato fillimisht plasojnë reportazhet, sepse veprimet e mëvonshme të KPM dhe KMSH mund të jenë jo efektive. Duke e konsideruar se ka pasur raste në të kaluarën ku raportimi mbi çështje ndëretnike ka shkaktuar konflikte të konsiderueshme, disa pjesëmarrës të fokus grupeve kanë treguar se e kanë perceptimin që mediat kanë filluar të shfaqin kujdes të shtuar gjatë raportimit të kësi lloj çështjeve. E njëjta gjë nuk mund të thuhet për raportimet brenda një grupi etnik, duke u bazuar në perceptimet e qytetarëve që tregojnë mbi ekzistimin e një trendi të përdorimit të ndasive politike apo fetare, për ta shtuar sensacionin e një reportazhi në mënyrë të tërheqjes të sa më shume shikimeve ose leximeve. Ky perceptim është më se i vërtetë për shtypin rozë, dhe portalet e internetit, për të cilat edhe rregullimi është i një vështirësie më të lartë.



Për më tepër, mungesa e raportimit të çështjeve ndëretnike mund të jetë shkaktar për konflikt në vete, veçanërisht kur konsiderohet roli pajtues që mediat mund ta luajnë. Kjo po ashtu është vërtetuar nga pjesëmarrësit e fokus grupeve, të cilët kanë konstatuar se rrallë herë i ndjekin ose i konsiderojnë mediumet e komuniteteve të tjera. Dy faktorë të mundshëm mund t'i veshën këtij fenomeni, i pari duke qenë barriera e gjuhës e cila ekziston ndërmjet komuniteteve dhe e dyta duke qenë vetë përmbajtja e lajmeve që merren me çështje ndëretnike. Barriera e gjuhës është e një rëndësie të veçantë, duke e konsideruar që pjesëtarët e komuniteteve të ndryshme nuk kanë mënyrë se si t'i përvetësojnë informatat e gjetura brenda medimeve të komuniteteve të tjera pa njohur gjuhën në të cilën mediimi prezanton informatën. Duke i konsideruar problemet e vazhdueshme financiare me të cilat përballohen mediat në Kosovë, është e vështirë të pritët nga mediumet që ta zgjedhin këtë çështje, sepse tejkalimi i saj do të mundësohej vetëm me më shumë financim. Përmbajtja e raportimeve ndëretnike është po ashtu shqetësuese, siç është vërtetuar edhe nga pjesëmarrës të ndryshëm të fokus grupeve. Është theksuar se përmbajtja e raportimeve ndëretnike është e një natyre tejte politike, diçka që shpesh herë krijon tensione ndërmjet komuniteteve. Duke e konsideruar këtë, mediat duhet të fokusojnë më shumë resurse tek mbulimi i çështjeve të natyrave praktike, si për shembull çështjet e ndryshme të cilat komunitetet i përballojnë në bazë ditore. Përmes këtij lloji raportimi mediat po ashtu do të jenë në gjendje që të eksplorojnë dhe ofrojnë kuptim të përbashkët, të cilin komunitetet e ndryshme mund ta përdorin për t'i anashkaluar konfliktet potenciale.

FORUMI
për
SIGURI